



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prilbato Received/Deliverty	11-01	702	1	viti god year
Organ /Bjësia Organ /Jednica Org./Unit	In. Pref. In. Pref. Pref No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOPSHACK	85/2021		1/4	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.NR.377/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.377/2020 të datës 27.11.2020, të parashtruar nga [REDACTED] me adresë rr."Bill Clinton" Lagja Dardania blloku 1 hyrja 2 Nr.14, Prishtinë, në çështjen juridike "Vlerësim i Rezultateve të Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.01.2021, në mënyrë unanime mori këtë;

V E N D I M

- I. Aprobuhet si e bazuar ankesa A. Nr. 377/2020, e datës 27.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II. Anulohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të datës 09.11.2020, i Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimi dhe Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të datës 25.11.2020, i Udhëheqësit të NJZP- Rrugët Rajonale, në Ministrinë e Infrastrukturës.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data pranimit të këtij vendimi, të ndërmerret te gjitha veprimet për zbatim të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës, i bërë me datë 09.11.2020 nga mbikëqyrësja e tij, me datë 27.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore së vlerësimi ka qenë i kundërligjshëm dhe tendencioz.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 01.12.2020, ka proceduar kërkesës për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës, ndërsa me datë 09.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegj për shqyrtimin e ankesës dhe vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.11.2020 me numër protokolli 2795/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2020; Akt Emërimin e datës 08.07.2014; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 09.11.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.12.2016; CV-ja e ██████████ Certifikatën e avancuar profesionale për prokurim me numër 361 e vitit 2020; Vendimin e datës 13.07.2018; Vendimin e datës 04.08.2020; Vendimin e datës 12.02.2019; Marrëveshjen e datës 27.12.2019; Përgjigjen në kërkesë e datës 09.12.2020; Marrëveshjen e datës 07.05.2019; e-mailin e datës 05.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 25.11.2020.

Kolegji pasi ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore për shqyrtimin e ankesës ashtu siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit ██████████, është e bazuar sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se vlerësimi vjetor për vitin 2020 i bërë nga udhëheqësja e tij me datë 09.11.2020 është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. Rregullore NR. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve Të Shërbimeve Publike.

Bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit, i nënshkruar nga Udhëheqësi me i Lartë Administrativ me datë 08.07.2014, ankuesi është i sistemuar në pozitën e Zyrtarit të Lartë të Prokurimit, në Divizionin e Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës.

Me vendimin Nr.620/2018 të datës 13.07.2018, të Ministrit të Infrastrukturës, për Themelimin e Njesisë Zbatuese të Projektit, Zgjerimi i Hyje-daljeve të Qytetit Ferizaj, Gjilan, Prizren që financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(BERZH), ankuesi është transferuar si anëtar i kësaj Njësie, e në të cilën ka vepruar deri me datë 04.08.2020 përkatësisht deri në shfuqizimi e Vendimit Nr. 620/2018, nga Ministri i Infrastrukturës me vendimin nr.5703 të datës 04.08.2020, e më të cilin Vendim anëtarët kësaj njësie janë rikthyer në pozitë që i mbajnë sipas Akt Emërimeve, duke nënkuptuar edhe rikthimin e ankuesit në pozitën e Zyrtari të Lart për Prokurim, në Divizionin e Prokurimit.

Udhëheqësja e Divizionit të Prokurimit znj. ██████████, mbikëqyrëse aktuale e ankuesit, i ka dorëzuar fizikisht ankuesit Formularin e vlerësimit të punës të datës 09.11.2020, ndërsa me datë 25.11.2020, Udhëheqësi i NJZP- Rrugët Rajonale, si mbikëqyrës i ankuesit deri me datë 04.08.2020, ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për periudhën mars 2019 deri korrik 2020.

Bazuar në Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji lidhur me vendosjen e ankesës ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti me neni 85 ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Kolegji gjatë analizimit të Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës të datës 09.11.2020, ka konstatuar se udhëheqësja e ankuesit me rastin e vlerësimit nuk ka specifikuar saktë periudhën e vlerësimit të rezultateve të punës, fakt ky që aktin si të tillë e bënë jo të plotë dhe të pa qartë.

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 43 paragrafi 1 ka përcaktuar: *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues, Ndërsa Rregullorja NR. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, përkatësisht neni 3 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 ka përcaktuar se: Vlerësimi i rezultateve në punë – nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore, kurse neni 8 paragrafi 2 i kësaj Rregullore ka paraparë se: Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak, Andaj, nga kjo rrjedhë se Udhëheqësja e Divizionit të Prokurimit, si mbikëqyrëse aktuale e ankuesit me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjor të lartcekura, përkatësisht ka bërë vlerësim ende pa përfunduar periudha e vlerësimit për vitin 2020, konkretisht vlerësimi vjetor është bërë me datë 09.11.2020. Po ashtu edhe Udhëheqësi i NJZP-Rrugët Rajonale ka vepruar në kundërshtim me aktet ligjore të lartshënuara, duke bërë vlerësim njëkohësisht për dy periudha vjetore përkatësisht për periudhën marsi – dhjetor 2019 dhe janar-korrik 2020.*

Ndërlidhur me periudhën e vlerësimit kolegji konstaton se vlerësimi mund të bëhet jashtë periudhës së vlerësimit vetëm në rast të: dorëheqjes, shkarkimit apo përfundimit të marrëdhënies së punës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores NR. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. E meqenëse lidhur me rastin kontestues nuk kemi asnjë nga gjendjet juridike të lartcekura, Kolegji konstaton se Formulari i Vlerësimit i datës 09.11.2020 dhe Formulari i Vlerësimit i datës 25.11.2020, janë lëshuar në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR. 21/2020.

Bazuar në gjendjen faktike dhe bazën juridike të konstatuar, Kolegji vlerëson se me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për ankuesin përkitazi me periudhën e vlerësimit për vitin 2020, personat përgjegjës për vlerësim janë të detyruar që të veprojnë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore si me lartë, si dhe në respektim të plotë të nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores NR. 21/2020 Për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet : *Nëse gjatë periudhës së vlerësimit në përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasuesm, si dhe nenin 8 të kësaj Rregullore.*

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar

edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A. Nr. 377/2020

Çlirim Zeka




Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit  
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës,
- Udhëheqësit të personelit në Ministrinë e Infrastrukturës
- Arkivit të KPMSHCK-së